

VENDIM
Nr.299, datë 24.5.2006

PËR KUOTAT KRYESORE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË UNIVERSITETIN
USHTARAK “SKËNDERBEJ”, PËR VITIN AKADEMIK 2006-2007

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 31 e 35 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat kryesore të pranimi në Universitetin Ushtarak “Skënderbej”, për vitin akademik 2006-2007, të jenë 120 (njëqind e njëzet) studentë, nga të cilat 20 për qind të jenë femra, kuota që ndahen sipas fakulteteve, si më poshtë vijon:

- a) Fakulteti i Menaxhimit, dega administrim-biznes 70 (shtatëdhjetë) studentë.
- b) Fakulteti Teknik, dega inxhinieri elektronike 50 (pesëdhjetë) studentë.

2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha